



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Statistikat e Kulturës 2024



Prishtinë, 2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Statistikat e Kulturës 2024



Prishtinë, 2025

Botues: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK)
Data e botimit: Tetor, 2025
© Agjencioni i Statistikës së Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qasen përmes ueb-faqes së ASK-së:
<http://ask.rks-gov.net>

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), përkatësisht Departamenti i Statistikave Sociale (DSS) ka përgatitur publikimin për aktivitetet kulturore të zhvilluara në vend.

Ky publikim përmban tregues për aktivitetet e teatrove, kinemave, galerive, të punësuarve në kulturë, studentët e regjistruar në arsimin e lartë sipas fushave të studimit të lidhura me kulturën, përdorimin e internetit për qëllime kulturore etj.

Të dhënat për aktivitet kulturore në vend janë marrë drejtpërdrejt nga Teatrot, Galeritë dhe Kinematë. Për përgatitjen e këtij publikimi janë përdorur burime administrative të të dhënave si dhe Anketat e zhvilluara në ASK.

Metodologjia e përdorur bazohet në rekomandimet e Eurostat-it.

Mirëpresim komentet, propozimet apo vërejtjet që kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së publikimit në të ardhmen në adresën: infoask@rks-gov.net

Publikimin punuan:

Naime Rexhepi - Drejtoresh e Departamentit të Statistikave Sociale

Bujar Hajrizi - Ud. i Udhëheqësit të Divizionit të Statistikave Sociale

Laureta Haziri - Zyrtare e Statistikave Kulturës dhe Sportit

Prishtinë, 2025

Drejt看 Ekzekutiv i ASK-së
Avni Kastrati

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MKRS	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
:	Shifra nuk është disponibël
-	Nuk aplikohet

Përmbajtja

Faqe

Shpjegime Metodologjike	8
Tab. 1: Numri i shfaqjeve/premierave dhe spektatorëve në Teatro 2024	11
Tab. 2: Numri i ekspozitave dhe vizitorë në Galeritë e Artit 2024	11
Tab. 3: Numri i filmave dhe shikuesve në Kinema	12
Fig. 1: Përqindja e studentëve të regjistruar (Bachelor dhe Master) në fushat e kulturës	12
sipas gjinisë, 2024/2025	12
Tab. 4: Punësimi në kulturë	13
Fig. 2: Punësimi në kulturë sipas gjinisë, (në %)	13
Përdorimi i internetit në kulturë	14
Tab. 5: Përdorimi i internetit për qëllime kulturore sipas gjinisë, (në %)	14
Fig. 3: Përdorimi i internetit për qëllime kulturore sipas grup-moshës 2024, (në %)	14
Tab. 6: Përdorimi i internetit në kulturë për blerjet online sipas gjinisë dhe grup- moshës (në %)	15
Fig. 4: Përdorimi i internetit në kulturë për blerje online sipas gjinisë 2024, (në %)	15
Tab. 7: Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit për disa mallra dhe shërbime kulturore	16
Fig. 5: Ndryshimi vjetor në përqindje të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit	16
për disa mallra dhe shërbime kulturore, 2023-2024	16
Shpenzimet Publike për Rekreacion, Kulturë dhe Religjion	17
Fig. 6: Shpenzimet publike dhe shpenzimet në kulturë për rekreacion, kulturë dhe religjion	17

Shpjegime Metodologjike

Pjesëmarrja kulturore

Të dhënat për pjesëmarrje kulturore i referohen institucioneve Teatrore, Kinemave dhe Galerive. Në institucione të artit e të kulturës përfshihen: Teatri Kombëtar i Kosovës, Teatri i Fëmijëve DODONA, Teatri ODA, Teatri Hadi Shehu, Teatri Bekim Fehmiu, Teatri Muharrem Qena, Teatri Adrian Abdullahu, Teatri Istref Begolli, Teatri i Qytetit Gjilan. Kinema Jusuf Gervalla, Doku-kino, Cineplexx, ABC, Hyrije Hana, Cinestar. Galeria Kombëtare e Kosovës, Galeria e Arteve Peje dhe Galeria e Arteve Ferizaj.

Teatro	Kinema	Galeri
Teatri Kombëtar i Kosovës	Jusuf Gervalla	Galeria e Arteve Kombëtare të Kosovës
Teatri për Fëmijë DODONA	Doku Fest	Galeria e Arteve Pejë
Teatri ODA	Cineplexx 1	Galeria e Arteve Ferizaj
Teatri Hadi Shehu	Cineplexx 2	
Teatri Bekim Fehmiu	ABC	
Teatri Muharrem Qena	Hyrije Hana	
Teatri Adriana Abdullahu		
Teatri Istref Begolli		
Teatri i Qytetit Gjilan		

Arsimi kulturor

Të dhënat mbi numrin e studentëve të regjistruar në arsimin e lartë në fushat e studimit të lidhura me kulturën ASK i ka grumbulluar përmes metodës CAWI nga Universitetet Publike dhe Kolegjet Private. Bazuar në klasifikimin e fushave të studimit (ISCED-F 2013), fushat që konsiderohen të lidhura me kulturën janë:

Fushat në kulturë
021 Arte
022 Shkenca humane
023 Gjuhet
032 Gazetari dhe informim
073 Arkitekture dhe ndërtim
1014 Sporte

Punësimi në kulturë

Të dhënat mbi punësimin në kulturë bazohen në Anketën e Fuqisë Punëtore, të dhëna vjetore dhe mbulojnë popullsinë 15 vjeç e më shumë. Punësimi kulturor përfshin të gjithë personat që punojnë në aktivitete ekonomike që konsiderohen të jenë kulturore, pavarësisht nëse personi është i punësuar në një profesion kulturor. Ai gjithashtu mbulon personat me një profesion kulturor, pavarësisht nëse ata janë të punësuar në një aktivitet ekonomik jo-kulturor. Përkufizimi i punësimit kulturor përcaktohet sipas Klasifikimit Statistikor të Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian (NACE Rev. 2) dhe Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Profesioneve (ISCO-08). Një listë e plotë e aktiviteteve ekonomike dhe profesioneve që janë përdorur për të përcaktuar punësimin kulturor është dhënë më poshtë.

Profesionet kulturore - ISCO-08
216 Arkitektët, planifikuesit, gjeodetët dhe dizajnerët
2353 Mësimdhënësit e tjerë të gjuhëve
2354 Mësimdhënësit e tjerë të muzikës
2355 Mësimdhënësit e tjerë të arteve
262 Bibliotekarët, arkivistët dhe kuratorët
264 Autorët, gazetarët dhe gjuhëtarët
265 Artistët kreativë dhe performues
3431 Fotografët
3432 Dizajnerët dhe dekoratorët e interiorit
3433 Teknikët e galerisë, muzeut dhe bibliotekës
3435 Bashkëpunëtorët e tjerë profesionalë
3521 Dizajnerët dhe dekoratorët e interiorit
4411 Nëpunësit në librari
7312 Prodhuesit dhe akorduesit e instrumenteve muzikore
7313 Punëtorët e stolive dhe metaleve të çmuara
7314 Poçarët dhe punëtorët e ngjashëm
7315 Prodhuesit, prerësit, mprehësit dhe përfunduesit e xhamit
7316 Punësit e shenjave, punëtorët për ngjyrosje dekorative, skalitës dhe gdhendës
7317 Punëtorët e zejes me dru, shportari dhe materiale të ngjashme
7318 Punëtorët e zejes me tekstil, lëkurë dhe materiale të ngjashme
7319 Punëtorë të zejes të paklasifikuar diku tjetër

Sektorët Kulturorë (aktivitetet ekonomike) — NACE Rev. 2
18 Shtypja dhe riprodhimi i mediave të inqizuara
32.2 Prodhimi i instrumenteve muzikore
58.1 Publikimi i librave, Periodikëve dhe aktivitetet tjera të Publikimit
59 Prodhimi i filmave, videove dhe programeve televizive, incizimi i zërit dhe aktivitetet e publikimit të muzikës
60 Aktivitete programore dhe të transmetimit
74.1 Aktivitetet e specializuara të dizajnit
74.2 Aktivitetet e fotografimit
74.3 Aktivitetet e përkthimit dhe interpretimit
90 Aktivitete krijuese, artistike dhe argëtuese
91 Bibliotekat, arkivat, muzetë dhe aktivitetet e tjera kulturore

Përdorimi i internetit për qëllime kulturore

Të dhënat mbi përdorimin e rregullt të internetit (3 muajt e fundit para realizimit të intervistës) nga individët 16-74 vjeç janë siguruar nga Anketa e Teknologjisë së Informativë dhe Komunikimit (TIK) në ekonomi familjare, që Agjencia e Statistikave të Kosovës zhvillon si anketë të rregullt vjetore.

Përdorimi i TIK për qëllime kulturore
Pjesëmarrja në rrjetet sociale (krijim profili duke postuar mesazhe ose aktivitete të tjera)
Komunikimi me mesazhe të shkruara (Skype, Messenger apo WhatsApp)
Leximi i lajmeve në gazeta / revista në internet

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

Të dhënat mbi indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit lidhur me mallrat dhe shërbimet kulturore janë siguruar nëpërmjet anketës të Çmimeve të Konsumit, që Agjencia e Statistikave të Kosovës e zhvillon me periodicitet mujor. Ky tregues bazohet në Klasifikimin Evropian të Shpenzimeve Individuale sipas Qëllimit (ECOICOP) me 12 ndarje kryesore.

ECOICOP- qëllime kulturore
CP091 Pajisje audio-vizuale, fotografike, dhe riparimi i tyre
CP0922 Instrumenta muzikore
CP0942 Shërbime kulturore
CP0951 Libra
CP0952 Gazeta dhe periodikë të tjerë

Shpenzimet Publike për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare

Të dhënat mbi shpenzimet publike për fushën e kulturës janë siguruar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Thesarit.

Tab. 1: Numri i shfaqjeve/premierave dhe spektatorëve në Teatro 2024

Institucione të Artit	Viti 2023	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2024
	Shfaqje/premiera dhe shfaqje të tjera	Shikues	Shfaqje/premiera dhe shfaqje të tjera	Shikues
Teatri Kombëtar i Kosovës	84	8 368	28	3 115
Teatri për Fëmijë DODONA	115	13 138	162	9 768
Teatri ODA	67	6 782	92	8 423
Teatri Hadi Shehu	29	1 700	19	800
Teatri Bekim Fehmiu	29	850	21	1 055
Teatri Muharrem Qena	5	610	19	2 500
Teatri Adriana Abdullahu	52	11 270	107	8 146
Teatri Istref Begolli	:	:	:	:
Teatri Qytetit Gjilan	119	13 209	116	16 558
Gjithsej	500	55 927	564	50 365

Burimi: Teatrot

Gjate vitit 2024 janë realizuar gjithsej 564 shfaqje dhe premiera në teatro, ku krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rritje të shfaqjeve dhe premierave për 12.8%. Ndërsa sa i përket numrit të spektatoreve në vitin 2024, ishte 50 365 , ku krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rënie për 9,9%.

Tab. 2: Numri i ekspozitave dhe vizitorë në Galeritë e Artit 2024

Institucione të Artit Pamore	Viti 2023		Viti 2024	
	Ekspozita	Vizitorë	Ekspozita	Vizitorë
Galeria e Arteve Kombëtare të Kosovës	13	38 000	8	35 000
Galeria e Ministris së Kulturës	5	1 900	-	-
Galeria e Arteve Pejë	-	-	-	-
Galeria e Arteve Ferizaj	10	7 500	13	5 500
Gjithsej	28	47 400	21	40 500

Burimi: Galeritë

Gjate vitit 2024 janë realizuar 21 ekspozita në galeritë e artit, ku krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rënje të numrit të ekspozitave për 25%. Ndërsa numri i vizitorëve në vitin 2024, ishte 40 500, ku krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rënje të numrit të vizitorëve për 14,5%.


Tab. 3: Numri i filmave dhe shikuesve në Kinema

Institucione të Kinemave	Viti 2023			Viti 2024		
	Filma të huaj	Filma vendas	Shikues	Filma të huaj	Filma vendas	Shikues
Jusuf Gervalla	98	27	8 348	127	26	3 524
Doku Fest	224	24	17 000	226	20	15 355
Cineplexx 1	121	7	176 737	129	12	108 661
Cineplexx 2	114	6	35 630	118	12	26 938
ABC	44	2	10 801	-	-	-
Hyrije Hana	112	8	14 200	118	4	9 995
Vizitore Gjithsej	713	74	262 716	718	74	164 473

Burimi: Kinematë

Gjatë vitit 2024 janë shfaqur 792 filma të huaj dhe vendas, ku krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rritje për 0,7%. Ndërsa numri i shikuesve në vitin 2024, ishte 164 473. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rënje të numrit të shikuesve për 37,4%.

Arsimi kulturorë

Fig. 1: Përqindja e studentëve të regjistruar (Bachelor dhe Master) në fushat e kulturës sipas gjinisë, 2024/2025

Burimi: Universitetet Publike dhe Kolegjet Private


Në fushat e studimit që lidhen me kulturën, femrat përbëjnë shumicën e numrit të studentëve me 64,2%. Përqindja e femrave është më e lartë në fushat “Gjuhë” (83,9%), “Gazetari dhe informim” (82,4%), “Arte” (66,7%) dhe në “shkenca humane” (54,7%) dhe më e ulët në fushën “Arkitektura dhe ndërtim” ku femrat përbëjnë (49,9%) dhe në sporte (30,5%) të studentëve në këtë fushë.

Tab. 4: Punësimi në kulturë

Punësimi në kulturë	Viti 2023			Viti 2024		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Numër	3 293	1 298	4 591	2 746	1 420	4 166
% ndaj punësimit gjithsej	1.1	1.1	1.1	0.9	1.2	1.0

Burimi: Anketa e Fuqisë Punëtore

Në vitin 2024, janë të punësuar në një aktivitet kulturor ose në një profesion kulturor 4 166 individë që përbejnë 1,0 % të punësimit gjithsej. Krahasuar me vitin e kaluar, punësimi në kulturë ka rënë për 0,1 pikë përqind në punësimin e përgjithshëm.

Fig. 2: Punësimi në kulturë sipas gjinisë, (në %)

Burimi: Anketa e Fuqisë Punëtore

Shumica e të punësuarve në kulturë janë meshkuj, respektivisht 65,9 % në vitin 2024. Krahasuar me vitin e kaluar, kjo përqindje ka rënë për 0,1 pikë përqind në punësimin e përgjithshëm.

Përdorimi i internetit në kulturë


Tab. 5: Përdorimi i internetit për qëllime kulturore sipas gjinisë, (në %)

Përdorimi i TIK për qëllime kulturore	Viti 2023		Viti 2024	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Pjesëmarrja në rrjetet sociale (krijim profili duke postuar mesazhe ose aktivitete të tjera)	67.1	32.9	51.5	48.5
Komunikimi me mesazhe të shkruara (Skype, Messenger apo WhatsApp)	66.2	33.8	49.3	50.7
Leximi i lajmeve në gazeta / revista në internet	68.8	31.2	49.5	50.5

Burimi: Anketa e përdorimit të Teknologjisë Informativë dhe të Komunikimit (TIK) në ekonomitë familjare dhe nga individët

Në analizën sipas aktiviteteve të kryera në internet gjatë 3 muajve të fundit, për tri kategoritë, janë femrat të cilat regjistrojnë përqindjet më të larta, mbi 50 %. Në vitin 2024, në analizën e të dhënave sipas gjinisë, meshkujt e përdorin më shumë internetin për Pjesëmarrje në rrjete sociale (krijim profili duke postuar mesazhe ose aktivitete tjera) (51,5%) ndërsa femrat e përdorin për komunikim me mesazhe të shkruara (Skype, Messenger apo WhatsApp) (50,7 %).

Fig. 3: Përdorimi i internetit për qëllime kulturore sipas grup-moshës 2024, (në %)



Burimi: Anketa e përdorimit të Teknologjisë Informativë dhe të Komunikimit (TIK) në ekonomitë familjare dhe nga individët

Në aktivitetet e përdorimit të internetit për qëllime kulturore vërehet se grup-moshat 16-24 e përdorin më shumë internetin për të gjitha aktivitetet kulturore, përderisa grup-moshat 25-54 vjeç e përdorin më shumë internetin për pjesëmarrje në rrjete sociale rreth 42,2%.


Tab. 6: Përdorimi i internetit në kulturë për blerjet online sipas gjinisë dhe grup-moshës (në %)

Viti 2024		Libra, revista, gazeta	Filma, muzikë	Bileta për evente (kinema, koncerte, evente sportive, panaire, etj)	Mallra sportive (përfshirë rroba sportive)	Roba (duke përfshirë veshjet sportive) këpucë, aksesore (çanta, bizhuteri etj)
Grup-mosha	16-24	5.5	3.2	8.9	19.3	57.5
	25-54	2.3	1.2	2.1	11.5	31.7
	55-74	0.6	0.9	1.1	4.7	10.8
Gjinia	Meshkuj	3	2.4	8.9	18.8	37.5
	Femra	5.4	2.9	11.5	16.7	40

Burimi: Anketa e përdorimit të Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit (TIK) në ekonomitë familjare dhe nga individët

Në aktivitetet e përdorimit të internetit për qëllime kulturore për blerjet online vërehet se të gjitha grup-moshat e përdorin më shumë internetin për të blerë Roba (duke përfshirë veshjet sportive) këpucë, aksesore (çanta, bizhuteri etj).

Fig. 4: Përdorimi i internetit në kulturë për blerje online sipas gjinisë 2024, (në %)




Burimi: Anketa e përdorimit të Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit (TIK) në ekonomitë familjare dhe nga individët

Në analizën sipas aktiviteteve të kryera në internet gjatë 3 muajve të fundit, në vitin 2024, në analizën e të dhënave sipas gjinisë, femrat e përdorin më shumë internetin për të blerë Roba (duke përfshirë veshjet sportive) këpucë, aksesore (çanta, bizhuteri etj) 40%.

Tab. 7: Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit për disa mallra dhe shërbime kulturore

Shërbime / Mallra Kulturore	Viti bazë: Dhjetor 2015=100	
	Viti 2023	Viti 2024
Pajisje audio-vizuale, fotografike, dhe riparimi i tyre	85.4	86.2
Instrumenta muzikore	107.7	108.5
Shërbime kulturore	117.0	121.9
Libra	103.9	110.0
Gazeta dhe periodikë të tjerë	100.0	100.0

Burimi: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit


Fig. 5: Ndryshimi vjetor në përqindje i indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit për disa mallra dhe shërbime kulturore, 2023-2024

Burimi: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

Në vitin 2024, rritja më e madhe e çmimeve për mallrat dhe shërbimet kulturore është shënuar për kategorinë “Libra” me 5,8%. Ndërsa, ulja më e madhe vërehet në kategorinë “Instrumenta muzikore” me 0,7%.

Shpenzimet Publike për Rekreacion, Kulturë dhe Religjion

Fig. 6: Shpenzimet publike dhe shpenzimet në kulturë për rekreacion, kulturë dhe religjion



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Thesarit

Në 2024, totali i shpenzimeve publike ishte 3 189 mln euro. Krahësuar me vitin e kaluar shpenzimet për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare ndaj totalit të shpenzimeve publike ka pasur rënje për 0,2 pikë përqindje.

Rreth Agjencisë së Statistikave të Kosovës

Përshkrim i shkurtër

Historiku i shkurtër - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është institucion profesional dhe i pavarur që merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare statistikore në nivel kombëtar. E themeluar që nga viti 1948, ASK ka kaluar nëpër faza të ndryshme zhvillimore, duke vepruar në përputhje me strukturat shtetërore të kohës.

Pas një ndërprerjeje në periudhën 1989–1999, ASK rifilloi aktivitetin më 2 gusht 1999 si institucion i pavarur brenda Ministrisë së Administratës Publike. Nga 1 korriku 2020 gati për dy vite të plota, veproi në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Aktualisht funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Financimi i ASK-së bëhet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga donatorë ndërkombëtarë për projekte specifike dhe ndihmë teknike.

Legjislacioni: ASK vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikën Zyrtare dhe ndryshimeve përkatëse përmes Ligjit Nr. 06/L-058. Struktura organizative përfshin Departamente Prodhuese si Departamenti i Statistikave Ekonomike, Departamenti i Llogarive Kombëtare, Departamenti i Statistikave Sociale, Departamenti i Statistikave të Bujqësisë e Mjedisit, Departamentet mbështetëse si Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative, Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim, Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit, Departamenti i Administratës. Në kuadër të Agjencisë veprojnë edhe Zyrat Rajonale në: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjiilan, Ferizaj dhe Mitrovicë.

Misioni i ASK-së - Të ofrojë të dhëna statistikore cilësore dhe të besueshme për të gjithë përdoruesit – institucione qeveritare, komunitetin akademik, sektorin privat dhe publikun e gjerë – në mbështetje të vendimmarrjes, planifikimit dhe zhvillimit të politikave në të gjitha nivelet.

Objektivi i ASK-së - Të prodhohen dhe shpërndahen të dhënat statistikore në mënyrë sistematike, të besueshme dhe të paanshme. Përfshirë shfrytëzimin profesional dhe standardet etike, d.m.th se politikat dhe praktikat janë transparente për shfrytëzuesit dhe respondentët e anketave.

Vizioni i ASK-së - Të jetë burimi kryesor dhe më i besueshëm i statistikave zyrtare në Kosovë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke mbështetur vendimmarrjen, transparencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Bashkëpunimet - Agjencia e Statistikave të Kosovës bashkëpunon me të gjitha Ministrinë e Qeveris së Kosovës sidomos me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe Bankën Qendrore të Kosovës ku edhe përbejnë Sistemin Statistikor të Kosovës. Agjencia ka bashkëpunim të ngushtë edhe me organizata ndërkombëtare si: EUROSTAT, FMN, Banka Botërore, INSTAT, SIDA, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, VIIES, IMF, ILO STAT, UNODC, ETF, IA, OECD si dhe me institucionet statistikore të rajonit.

Gjatë vitit 2024, u realizua me sukses Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë – një projekt kyç për hartimin e politikave zhvillimore të qëndrueshme.

ASK mbulon tërë territorin e Republikës së Kosovës përmes rrjetit të njëjësive raportuese dhe qarqeve statistikore, duke siguruar të dhëna të dorës së parë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Adresa:

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë

Telefoni:

+383 (0) 38 200 31 129

Kryeshefi Ekzekutiv:

+383 (0) 38 200 31 112

Fax:

+383 (0) 38 235 033

E-mail:

infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe:

<http://ask.rks-gov.net>